

VENDIM I BORDIT TË FEDERATËS SË BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Lënda: Lejimi i lojtarëve të huaj për të luajtur në xhiron e shtyrë të 21-të të ProCredit Superligës së Meshkujve

Data: 25.02.2025

Vendi: Prishtinë

Duke marrë parasysh:

- Vendimin e Bordit të Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK) për shtyrjen e tri ndeshjeve të xhiros së 21-të të ProCredit Superligës së Meshkujve për datat 26 dhe 27 shkurt, për shkak të angazhimit të palestrave nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), me përjashtim të ndeshjes Sigal Prishtina - Vëllaznimi.
- Kërkesat e paraqitura nga klubet për regjistrimin dhe lejimin e lojtarëve të huaj për të luajtur në ndeshjet e shtyra.
- Nenin 59.4. të Propozicioneve të Garave të FBK-së që përcakton se interpretimin e këtyre Propozicioneve e jep Bordi i FBK-së.

Bordi i Federatës së Basketbollit të Kosovës vendos:

1. **Të lejojë** paraqitjen e lojtarëve të huaj të regjistruar së fundi, në ndeshjet e shtyra të xhiros së 21-të:
2. **Ky vendim hyn në fuqi menjëherë** dhe është i detyrueshëm për të gjitha palët e përfshira.
3. **Komisioni i Garave** është i autorizuar për zbatimin dhe mbikëqyrjen e këtij vendimi në përputhje me Propozicionet e Garave të FBK-së.
4. **Sekretarja e Përgjithshme e FBK-së**, Elvira Dushku, ngarkohet për publikimin e vendimit në kanalet zyrtare të FBK-së.

Me respekt,

Arben **FETAHU**
Kryetar



Federata e Basketbollit të Kosovës



FEDERATA E BASKETBOLLIT TË KOSOVËS

Tel: +383 49 738-080, E-mail: federata@basketbolli.com, Lagjia "Arbëria", Blloku C3, Nr: 83, Str: Radovan Zogovic, 10 000, Prishtina